



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2024:010732

Datë: 16.05.2024

Numri i dokumentit: 05697101

KPPP.nr. 72/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, me gjyqtarin Florent Zeqiri, në çështjen përbarimore të kreditorit Inspektorati i Punës në Kosovë-Ministria e Financave Punës dhe Transfereve, kundër debitorit “CGV” Sh.p.k., (HAJDE), me numër unik identifikues 811849530 dhe me seli në Prishtinë, rr. “Bajram Kelmendi”, nr.15, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër Urdhrit Përbarimor P.nr. 2048/2023 të datës 19.12.2023, të lejuar nga Përbaruesi Privat Valdrin Beka, me seli në Prishtinë, jashtë seancës me datë 16.05.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET në tërësi si i pabazuar prapësimi i debitorit “CGV” Sh.p.k., (HAJDE), ndërsa Urdhri Përbarimor P.nr. 2048/2023 i datës 19.12.2023, i lejuar nga Përbaruesi Privat Valdrin Beka, MBETET NË FUQI.

A r s y e t i m

Përbaruesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit Inspektorati i Punës në Kosovë-Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, në bazë të dokumentit përbarues - Vendimit Nr.01/50-202/23Gj i datës 05.09.2023 ka caktuar zbatimin e përbarimit përmes urdhrit përbarimor P.nr. 2048/2023 të datës 19.12.2023 ndaj debitorit “CGV” Sh.p.k., (HAJDE), të cilin e ka detyruar që në emër të masës ndëshkimore të shqiptuar sipas aktvendimit të lartcekur, t’ia paguaj kreditorit shumën e borxhit prej 1,100.00 EUR (njëmijë e njëqind euro), nën kërcënim të ekzekutimit të dhunshëm me ndalimin e mjeteve në para të cilat debitori i ka në llogaritë bankare dhe në shitje të sendeve të luajtshme pronë e debitorit, si dhe shpenzimet e procedurës përbarimore.

Debitori në prapësimin e paraqitur brenda afatit ligjor ka deklaruar se dokumenti në bazë të cilit është lejuar përmbartimi nuk i plotëson kushtet e parapara ligjore për tu konsideruar dokument përmbartimor, pasi që vendimet e nxjerra nga Inspektorati i Punës janë vendime të nxjerra pa një kontest të rregullt të punës, e të njëjtat janë të nxjerra dhe të bëra të plotfuqishme e të ekzekutueshme nga vetë inspektorati. Pastaj ka theksuar se këto vendime janë të një anshme dhe pa të drejtë kundërshtimi. Andaj i ka propozuar gjykatës që duke u bazuar në shkeljet e theksuar më lartë që propozimin për përmbartim ta hedhë poshtë si të pa lejuar, ndërsa çështja të dërgohet në kontest të rregullt civil, pra në kontest të punës.

Kreditori në përgjigje në prapësim ka theksuar se propozimin për përmbartim e ka parashtruar si rezultat i mos pagesës së detyrimeve të debitorit në mënyrë vullnetare dhe se pretendimet e debitorit për kundërshtimin e procedurës përmbartimore si e pa bazë e pa qëndrueshme dhe e pa ligjshme nuk qëndrojnë pasi që dokumenti në bazë të cilit është lejuar përmbartimi është i bazuar, i argumentueshëm dhe i ekzekutueshëm. Andaj i ka propozuar gjykatës së ta refuzojë prapësimin e debitorit dhe ta lë në fuqi Urdhrin Përmbartimor P.nr. 2048/23 të datës 19.12.2023 të lejuar nga Përmbartuesi Privat Valdrin Beka.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbartimore, (tutje LPP) gjeti se prapësimi i debitorit është në tërësi i pabazuar andaj të njëjtin e refuzoi dhe vendosi si në dispozitiv të këtij Aktvendimi, për shkaqet si në vijim:

Gjykata vlerëson se organi përmbartues ka lejuar përmbartimin bazuar në nenin 21 të LPP-së i cili përcakton se: *“Organi përmbartues e cakton, përkatësisht e zbaton përmbartimin vetëm në bazë të dokumentit përmbartues (titulus executionis) dhe dokumentit të besueshëm, po qe se me këtë ligj nuk është parashikuar diçka tjetër.”*

Gjykata ka shqyrtuar dokumentin përmbartimor, përkatësisht Vendimin Nr.01/50-202/2023Gj të datës 05.09.2023, në bazë të së cilit përmbartuesi privat ka lejuar përmbartimin dhe gjeti se i njëjti, konform nenit 22 par. 1, nën-par. 1.2 të LPP-së, është përcaktuar si dokument përmbartues sipas të cilit mund të caktohet përmbartimi për realizimin e kërkesës në të holla, dhe i cili vendim i përmban të gjitha elementet e përcaktuara në nenin 27 paragrafin 1, sipas të cilit: *“Dokumenti përmbartimor është i përshtatshëm për përmbartim në qoftë se në të është treguar kreditori dhe*

debitori, si dhe objekti, mjetet, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit”, pasi që në të është treguar kreditori, debitori, objekti, mjetet, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit.

Gjykata tutje vlerëson se Vendimi Nr.01/50-202/2023Gj i datës 05.09.2023, i plotëson kushtet e përcaktuara edhe në nenin 36 paragrafin 1 të LPP-së, sipas të cilit përcaktohet se: *“Së bashku me propozimin për përmbarim, organit përmbarues i dorëzohet edhe dokumenti përmbarues, origjinal apo kopje e vërtetuar, me klauzolën e përmbarueshmërisë për përmbarueshmëri”*, ngase aktvendimi i lartcekur është i pajisur me klauzolën e përmbarueshmërisë nga e cila rezulton se i njëjti është bërë i formës së prerë dhe i ekzekutueshëm me datë 31.10.2023.

Gjykata i vlerësoi pretendimet e debitorit lidhur me shqyrtimin e ligjshmërisë së dokumentit përmbarues, mirëpo gjeti se të njëjtat nuk janë objekt shqyrtimi i procedurës përmbarimore, prandaj dhe nuk mund të vlerësohen në këtë procedurë, ngase kjo procedurë i nënshtrohet parimit të rigorozitetit formal, në bazë të cilit nuk lejohet vlerësimi i rrethanave tjera, përpos vlerësimit të elementeve formale të dokumentit në bazë të cilit është lejuar përmbarimi, si dhe përshtatshmërisë së vendimit objekt përmbarimi, ashtu siç kërkohet me dispozitat e neneve 21, 22, 24 dhe 27 të LPP-së.

Nga arsyet e paraqitura më lartë, dhe duke u bazuar në nenin 73 par.1 dhe par. 3 të LPP-së, nenin 13 par.1 nën par 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr. 72/24, datë 16.05.2024

Gjyqtari
Florent Zeqiri

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së parë të kësaj Gjykate.